

## AKT THEMELIMI

### I

## SHOQËRISË TREGTARE KREM SHPK

Në bazë të ligjit nr.7638, dt.19.11.1992 “Për Shoqëritë tregtare” dhe atij nr.7667 dt.28.01.1993 “Për regjistrin tregtar”, me vullnetin e tij të lirë Znj. Sueda Guri, e bija e Maksit, e datëlindjes 07/03/1983 lindur në Tiranë, banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shpall si vijon:

### Neni 1

Formohet Shoqëria tregtare e emëruar KREM sh.p.k me themelues Znj. Sueda Guri dhe date themelimi: 09/06/2022.

### Neni 2

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesit të saj në kapitalin themeltar.

### Neni 3

1. Shoqëria e ka seline në adresën ***Autostrada Tirane-Durres, km 6, QendraTregtare Univers, Kioska Nr.29, Tirane Shqiperi***

Ajo mund të celë edhe seli të tjera të dyta, degë ose filiale, përfaqësi dhe agjensi operative, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

### Neni 4

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e saj për një periudhe të pacaktua .

### Neni 5

Objekt i veprimtarisë së saj do të jenë:

- A) Import – Ekport dhe tregwtim me pakice dhe shumice i produkteve ushqimore.
- B) Organizimi dhe zbatimi i fushave promovuese, eventeve dhe evenimenteve të cdo lloji, veprimtari marketingu, promocioni dhe distribucioni per të gjitha llojet e shërbimeve dhe mallrave për llogari të vetat, ose në funksion të të tretëve. Konceptimi, organizimi dhe menaxhimi i reklamavetë fushatave, eventeve, fushatave të marketingut, marrëdhënieve me publikun, spoteve publicitare, në fushën e design-it, publikimeve, reklamave dhe promocionit.
- C) Import-Eskport, makineri industriale dhe ndërtimi, pajisje elektronike, automjete të reja dhe të përdorura, materiale bujqësore dhe ushqimore, fruta perime, pjesë këmbimi goma bateri. Punime druri dhe mobilje, duralumini metalike. Import-Eksport konfeksione, paisje hidrosanitare, hidraulike, elektrike dhe kancelari. Tregtim të disinfektantëve e pesticideve dhe makineri mjekësore. Mirëmbajtje ambjenteve të jashtme si gjelbërim dhe pastrim tyre. Import –Eskport si dhe tregti me shumicë e pakicë të paisjeve mjekësore. Aktivitet në fushën e tregtimit të materialeve të pastrimit.
- D) Shpërndarje, shitje me shumicë dhe pakicë import- eksport të materialeve optike dhe instrumenteve optikë, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, askesorë të modës dhe këpucëve si dhe cdo veprimtari të lidhur me to. Kryerja e cdo lloj operacioni tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe hipotekore që lidhen me to, operacione financiare kredimarrje, të japë garanci të tretëve si edhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërrmarrje, degë ndërrmarrjesh, si dhe të ketë pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithësesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.
- E) Kryerja e aktiviteteve, për të cilat nevojiten lejet dhe/ose miratimet përkatëse, do të bëhet pas marrjes së këtyre lejeve dhe/ose miratimeve.

#### **Neni 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 leke i përbërë nga kontributi i ortakut të vetëm themelues. Kapitali themelues mund të ndryshojë nga vendimet që mund të marrë ky ortak i vetëm, por asnjëherë të pakësohet nën nivelin e kapitali themeltar. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

#### **Neni 7**

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje KREM Shpk, Tirane, Albania.

**Neni 8**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

-Ortaku i vetëm

-Administratori

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet në statut.

**Neni 9**

Administrator i shoqërisë KREM është Znj. Sueda Guri, e bija e Maksit, e datëlindjes 07/03/1983, banues në Tiranë.

Afati I administratorit eshte per 5 vjet dhe fillon nga data: 09/06/2022 deri ne date 09/06/2027.

**Neni 10**

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij akti-themelimi dhe me statutin bashkëlidhur këtij akti.

**Neni 11**

Ky Akt përpilohet në disa kopje për tu shpërndarë në organet kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e Shoqërisë.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË TREGTARE**

**KREM SHPK**

**SUEDA GURI**

*Sueda Guri*  
